

Prot. no. 174  
dt. 20.02.2024

Prot. no. 93  
dt. 20.02.2024



**AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL/  
CIVIL AVIATION AUTHORITY**

**AUTORITETI KOMBËTAR I  
INVESTIGIMIT TË AKSIDENTEVE TË  
SIGURISË SË OPERIMIT NË AVIACIONIN/  
CIVIL NATIONAL AUTHORITY FOR  
SAFETY INVESTIGATION IN CIVIL  
AVIATION**

<p><b>MEMORANDUM BASHKËPUNIMI MIDIS</b></p> <p><b>AUTORITETI KOMBËTAR SHQIPTAR TË INVESTIGIMIT TË AKSIDENTEVE TË SIGURISË SË OPERIMIT NË AVIACIONIN CIVIL (AKISA)</b></p> <p><b>DHE</b></p> <p><b>AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL SHQIPTAR (AAC)</b></p> <p><b>PËR KOORDINIMIN E AKTIVITETEVE LIDHUR ME INVESTIGIMIN E NGJARJEVE TË TRANSPORTIT AJROR</b></p>	<p><b>MEMORANDUM OF UNDERSTANDING BETWEEN</b></p> <p><b>THE ALBANIAN NATIONAL AUTHORITY FOR SAFETY INVESTIGATION IN CIVIL AVIATION (AKISA)</b></p> <p><b>AND</b></p> <p><b>ALBANIAN CIVIL AUTHORITY (ACAA)</b></p> <p><b>ON THE COORDINATION OF ACTIVITIES WITH REGARD TO AIR TRANSPORT OCCURRENCES</b></p>
<p><b>1.0 QËLLIMI</b></p> <p>1.1 Qëllimi i këtij Memorandumi Bashkëpunimi (MOU) është të sigurojë bashkërendimin e aktiviteteve të AKISA-s dhe ACAA-së në lidhje me ngjarjet e transportit ajror, të parashikuar nga Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.739, datë 12.03.2021 "Për organizimin dhe funksionimin e autoritetit kombëtar të investigimit për sigurinë e operimit në aviacionin civil dhe rregullat për procesin e investigimit".</p> <p><b>2.0 PARIMET</b></p> <p>2.0 AAC dhe AKISA e shprehin dëshirën e bashkëpunimit përmes:</p>	<p><b>1.0 PURPOSE</b></p> <p>1.1 The purpose of this Memorandum of Understanding (MOU) is to provide for the coordination of the activities of AKISA and ACAA with respect to air transport occurrences, as contemplated by the Decision of Council of Ministers No. 739, dated 03.12.2021 "On the organization and functioning of the national investigation authority for the safety of operation in civil aviation and the rules for the investigation process".</p> <p><b>2.0 PRINCIPLES</b></p> <p>2.1 ACAA and AKISA recognize the desirability of cooperation through:</p>

<p>(a) marrëdhënieve pozitive të punës;  (b) shkëmbimit efektiv dhe efikas të informacionit dhe të dhënave;  (c) shkëmbimit të personelit ekspert;  (d) komunikimit të qartë dhe të hapur;  (e) respektimit të mandatit dhe përgjegjësi të secilës organizatë; dhe  (f) zgjidhjes së menjëhershme të çdo konflikti që lind, duke e referuar në nivele më të larta brenda secilës organizatë, aty ku është e përshtatshme ose kur kërkohet tek Ministri përgjegjës për transportin.</p>	<p>(a) positive working relationships;  (b) the effective and efficient exchange of information and data;  (c) exchange of expert personnel;  (d) clear and open communication;  (e) respect for the mandate and responsibilities of each organization; and  (f) the prompt resolution of any conflicts which arise, by referring them to more senior levels within each organization, where appropriate or required by the Minister in charge for transport.</p>
<p><b>3.0 AUTORITETET DHE PËRGJEGJËSITË</b></p>	<p><b>3.0 AUTHORITIES AND RESPONSIBILITIES</b></p>
<p>3.1 Drejtori Ekzekutiv i AKISA-s është përgjegjës për administrimin e autoritetit kombëtar të investigimit të sigurisë së operimit në aviacionin civil.</p>	<p>3.1 The Director Executive of AKISA is responsible for the administration of the national authority for the safety investigation in civil aviation.</p>
<p>3.2 Për qëllim të këtij dokumenti, Ministri përgjegjës për transportin është përgjegjës për:</p> <p>a) vendosjen e politikave të aviacionit civil në Republikën e Shqipërisë;  b) negociimin dhe nënshkrimin e marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe për transportin ajror;  c) përfaqësimin e Republikës së Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare të aviacionit civil;  d) nxjerrjen e akteve nënligjore të nevojshme për zbatimin e Kodit Ajror të Shqipërisë dhe legjislacionit ndërkombëtar, si dhe në kuadrin e marrëveshjes shumëpalëshe.</p>	<p>3.2 For the purpose of this document, the Minister in charge of transport is responsible for:</p> <p>a) the establishment of civil aviation policies in the Republic of Albania;  b) negotiation and signing of bilateral and multilateral agreements for air transport;  c) the representation of the Republic of Albania in international civil aviation organizations;  d) issuing the by-laws necessary for the implementation of the Air Code of Albania and international legislation, as well as within the framework of the multilateral agreement.</p>
<p>3.3 AKISA është një organ i pavarur i ngarkuar për të çuar përpara sigurinë e transportit, duke kryer investigime të pavarura të ngjarjeve të caktuara në aviacion, me qëllim që të konstatohen shkaqet dhe faktorët kontribues të tyre, të identifikohen mangësitë e sigurisë, të bëhen rekomandime për eliminimin ose reduktimin e mangësi të tilla dhe duke raportuar publikisht mbi hetimet dhe gjetjet e tij.</p>	<p>3.3 AKISA is an independent body with the mandate to advance transportation safety, by conducting independent investigations of selected occurrences in the aviation, in order to make findings as to their causes and contributing factors, to identify safety deficiencies, to make recommendations to eliminate or reduce such safety deficiencies and by reporting publicly on its investigations and its findings.</p>
<p>3.4 AAC ofron programe dhe shërbime të ndryshme për të rregulluar dhe mbikëqyrur sigurinë në operim dhe sigurinë e aviacionit civil.</p>	<p>3.4 ACAA delivers various programs and services to regulate and oversee transportation safety and security.</p>
<p>3.5 Drejtori Ekzekutiv i AAC-së është drejtuesi i Autoritetit, i ngarkuar me të gjitha funksionet e</p>	<p>3.5 The Executive Director of ACAA is the head of the Authority, in charge of all functions nec-</p>

nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të AAC-së, të përcaktuara në Ligjin Nr. 96/2020 "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë" dhe në Ligjin Nr. 53/2022 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil".

#### **4.0 NJOFTIMI I INCIDENTEVE**

4.1 Pala e informuar fillimisht për një incident, do të njoftojë palën tjetër sa më shpejt të jetë e mundur, në përputhje me procedurën e përcaktuar në Seksionin 2 të Skedulës së kësaj MOU-je.

4.2 Ndërkohë, AAC do të mundësojë aksesin e AKISA në bazën kombëtare të të dhënave, nëpërmjet një llogarie përdoruesi, që AKISA ta përdorë sipas nevojës gjatë ushtrimit të funksioneve të saj.

#### **5.0 NJOFTIM PËR STUDIME TË RËNDËSISHME DHE INVESTIGIME TË TJERA**

5.1 Secila palë do të këshillojë tjetrën për studime ose investigime të rëndësishme që planifikojnë të kryejnë, të cilat mund të jenë me interes për palën tjetër.

#### **6.0 SHKËMBIMI I EKSPERTËVE**

6.1 AKISA dhe AAC do të mundohen të përmbushin kërkesat për ndihmë nga njëri-tjetri, duke përfshirë shkëmbimin e ekspertëve përkatës. Organizata që kërkon të përmbushë një kërkesë të tillë, do të marrë parasysh çështjet në Seksionin 3 të Skedulës së kësaj MOU-je, si dhe çështjet që përfshijnë përfitimet e sigurisë, kërkesat legjislative, burimet e disponueshme, politikat e brendshme dhe menaxhueshmërinë e konflikteve të mundshme të interesit që lindin nga shkëmbimi i personelit.

#### **7.0 MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE**

7.1 Të dyja palët do të punojnë në mënyrë bashkëpunuese për të zhvilluar pozicionet e koordinuara të Shqipërisë si dhe për të koordinuar përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e tyre në takime dhe ngjarje ndërkombëtare, siç janë takimet e ICAO-s.

essary to discharge the obligations of the CAA, as stipulated in the Law No.96/2020 "Air Code of the Republic of Albania" and in the Law No.53/2022 "On the organization and functioning of the Civil Aviation Authority".

#### **4.0 NOTIFICATION OF OCCURRENCES**

4.1 The party first informed of an occurrence, will notify the other party as soon as practicable, in accordance with the procedure set out in Section 2 of the Schedule in this MOU.

4.2 Meanwhile, ACAA will provide the access of AKISA to the National Database of occurrences, through a user account, for AKISA to use it as needed for the performance of its functions.

#### **5.0 NOTICE OF SIGNIFICANT STUDIES AND OTHER INVESTIGATIONS**

5.1 Each party will advise the other of significant studies or investigations they plan to conduct that may be of interest to the other.

#### **6.0 EXCHANGE OF EXPERT PERSONNEL**

6.1 AKISA and ACAA will seek to accommodate requests for assistance from one another, involving the exchange of expert personnel. The organization seeking to accommodate such a request, will take into account the matters in Section 3 of the Schedule in this MOU, as well as matters involving the safety benefits, legislative requirements, available resourcing, internal policies and the manageability of potential conflicts of interest arising from the exchange of personnel.

#### **7.0 INTERNATIONAL RELATIONS**

7.1 Both parties will work cooperatively to develop coordinated Albanian positions as well as to coordinate their representation and participation at international meetings and events, such as meetings of ICAO.

## **8.0 MARRËDHËNIET ME MEDIAN**

**8.1** Palët pranojnë se AKISA do të jetë zëdhënësi zyrtar në lidhje me çdo investigim aksidenti që AKISA ndërmer.

**8.2** Secila palë mund t'u përgjigjet kërkesave për informacion nga media në lidhje me mandatin dhe aktivitetet e saj. Secila palë do të përpiqet të njoftojë dhe t'i japë detaje palës tjetër përpara publikimit të komunikatave zyrtare ose njoftimeve për shtyp, të cilat mund të jenë me interes ose me ndikim në mandatin ose aktivitetet e palës tjetër.

## **9.0 NDARJA E KOSTOVE**

**9.1** Përveç rasteve kur është rënë dakord ndryshe paraprakisht, ofrimi normal i shërbimeve të njëjës palë ndaj tjetrës do të jetë pa pagesë.

## **10.0 KONSULTIMI**

**10.1** Secila palë do të konsultohet dhe do të përfshijë tjetrën për çështje që mund të jenë me interes, duke përfshirë ndryshimet rregullatore ose iniciativat. Secila palë do të përpiqet të përmbushë kërkesat e palës tjetër në lidhje me zhvillimin rregullator. Një përfshirje e tillë duhet të përfshijë, aty ku është e përshtatshme, dhënien e informacionit teknik dhe pjesëmarrjen në konsultimet me industrinë gjatë zhvillimit të propozimeve rregullatore.

## **11.0 RISHIKIMI**

**11.1** Kjo MOU dhe zbatimi i saj do të rivlerësohet nga palët çdo vit dhe mund të rishikohet me kërkesë të secilës palë.

## **12.0 SKEDULA**

**12.1** Skedula bashkëngjitur është pjesë e kësaj MOU-je dhe mund të ndryshohet herë pas here me marrëveshje me shkrim të Drejtorëve Ekzekutivë të AAC-së dhe AKISA-s.

## **8.0 MEDIA RELATIONS**

**8.1** The parties acknowledge that the AKISA is to be the official spokesperson regarding any accident investigation that the AKISA undertakes.

**8.2** Each party may respond to requests for information from the media concerning its mandate and activities. Each party will endeavor to provide notice and details to the other party in advance of the release of formal communiques or press releases, which may be of interest to, or impact on, the mandate or activities of the other party.

## **9.0 COST SHARING**

**9.1** Except as otherwise agreed to in advance, normal provision of services by one party to the other will be without charge.

## **10.0 CONSULTATION**

**10.1** Each party will consult with and involve the other on matters which may be of interest, including regulatory changes or initiatives. Each party will endeavor to accommodate the requirements of the other party with respect to regulatory development. Such involvement should include where appropriate, the provision of technical information and participation in consultations with industry during the development of regulatory proposals.

## **11.0 REVIEW**

**11.1** This MOU and its implementation will be asessed by the parties annually and will be reviewed at the request of either party.

## **12.0 SCHEDULE**

**12.1** The attached Schedule forms part of this MOU and may be amended from time to time on the written agreement of the Executive Directors of ACAA and AKISA.

**13.0 NDRYSHIMET DHE PËRFUNDIMI**


13.1 Kjo MOU mund të ndryshohet me shkrim nëpërmjet një marrëveshjeje me shkrim të palëve dhe mund të zgjidhet nga secila palë me njoftim me shkrim 180 ditë para.

**13.0 AMENDMENTS AND TERMINATION**

13.1 This MOU may be amended in writing by the written agreement of the parties and may be terminated by either party on 180 days written notice.

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL  
SHQIPTAR/

ALBANIAN CIVIL AVIATION  
AUTHORITY



*Maksim Et'hemaj*  
MAKSIM ET'HEMAJ  
DREJTOR EKZEKUTIV/  
EXECUTIVE DIRECTOR

Data e nënshkrimit/

Date signed: 20.02.2024


AUTORITETI KOMBËTAR I  
INVESTIGIMIT TË SIGURISË NË OPERIM  
NË AVIACIONIN CIVIL/  
NATIONAL AUTHORITY FOR SAFETY  
INVESTIGATION IN CIVIL AVIATION

*Genci Resuli*

GENCI RESULI  
DREJTOR EKZEKUTIV/  
EXECUTIVE DIRECTOR

Data e nënshkrimit /

Date signed: \_\_\_\_\_



SKEDULA	SCHEDULE
<p><b>1.0 QËLLIMI</b></p> <p>1.1 Qëllimi i kësaj skedule është të përcaktojë përgjegjësitë specifike të AAC-së dhe AKISA-s në lidhje me zbatimin e Memorandumit të Bashkëpunimit (MOU).</p> <p><b>2.0 NJOFTIMI I NGJARJEVE</b></p> <p>2.1 Për njoftimin e menjëhershëm të ngjarjeve të raportueshme, siç përcaktohet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 739, datë 12.03.2021 "Për organizimin dhe funksionimin e autoritetit kombëtar të investigimit për sigurinë e operimit në aviacionin civil dhe rregullat për procesin e investigimit" dhe Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 89, datë 05.05.2022 për miratimin e rregullore "Për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë":</p> <p>(a) AAC do të njoftojë zyrën përkatëse të AKISA-s për çdo ngjarje aviacioni të raportueshme, sa më shpejt të jetë e mundur;</p> <p>(b) AKISA do të njoftojë Qendrën e Emergjencave Civile për çdo ngjarje aviacioni, sa më shpejt të jetë e mundur;</p> <p>Njoftimi zyrtar për hetimet e AKISA-s:</p> <p>(c) AKISA do të informojë AAC-në, brenda 48 orëve nga marrja dijeni për një ngjarje, se çfarë veprimi ka ndërmend të ndërmarrë AKISA, duke përfshirë nivelin e hetimit. Ky informacion normalisht duhet të reflektohet në dokumentin përkatës të regjistrave të AKISA-s;</p> <p>(d) AKISA do të raportojë ngjarjet e aviacionit, duke treguar llojin dhe regjistrimin e avionit, vendndodhjen, datën dhe kohën e ngjarjes, numrin e të lënduarve dhe viktimave, të dhënat në lidhje me përfshirjen e mallrave të rrezikshme, përshkrimin e shkurtër të rrethanave dhe veprimin e planifikuar nga AKISA.</p> <p>2.2 Nëse AAC beson se, për të përcaktuar gjetjet në lidhje me shkaqet dhe faktorët kontribues, është i nevojshëm hetimi i një incidenti, kur AKISA ka vendosur të mos hetojë, AAC mund të kërkojë që AKISA të kryejë një hetim.</p> <p>2.3 Nëse AAC kryen një hetim incidenti, brenda autoritetit të tij legjislativ, do të informojë</p>	<p><b>1.0 PURPOSE</b></p> <p>1.1 The purpose of this schedule is to outline the specific responsibilities of ACAA and the AKISA regarding the implementation of the Memorandum of Understanding (MOU).</p> <p><b>2.0 NOTIFICATION OF OCCURRENCES</b></p> <p>2.1 For immediate notification of reportable occurrences, as defined in the Decision of Council of Ministers No. 739, dated 03.12.2021 "On the organization and functioning of the national investigation authority for the safety of operation in civil aviation and the rules for the investigation process" and Minister of Infrastructure and Energy Order No. 89, dated 05.05.2022 for the approval of the regulation "For the reporting and follow-up of occurrences in civil aviation in the Republic of Albania":</p> <p>(a) ACAA will notify the appropriate AKISA office of any reportable aviation occurrence, as soon as practicable;</p> <p>(b) AKISA will notify Civil Emergencies Center of any aviation occurrence, as soon as practicable;</p> <p>Formal notification of AKISA investigations:</p> <p>(c) The AKISA will inform ACAA, within 48 hours of learning of an occurrence, what action AKISA intends to take, including the class of investigation. This information shall normally be provided in AKISA respective logs document;</p> <p>(d) AKISA will report aviation occurrences, indicating aircraft type and registration, location, date and time of the occurrence, number of injuries and fatalities, particulars relating to involvement of dangerous goods, brief description of the circumstances and the action planned by AKISA.</p> <p>2.2 If ACAA believes an investigation of an occurrence is required to determine findings as to causes and contributing factors, where AKISA has decided not to investigate, ACAA may request that AKISA conduct an investigation.</p> <p>2.3 If ACAA conducts an occurrence investiga-</p>

AKISA-n.

2.4 Kur AKISA vlerëson nevojën për të kryer një investigim për një ngjarje, AAC mund të vendosë të kryejë hetimin e saj aty ku është e autorizuar ta bëjë këtë. AAC do të informojë AKISA-n për vendimin e saj për kryerjen e një hetimi, sa më shpejt të jetë e mundur.

### **3.0 KOORDINIMI I VEPRIMTARIVE HETIMORE**

3.1 Në lidhje me incidentet që AKISA heton, AAC do të vërë në dispozicion, sipas kërkesës, sa më shpejt të jetë e mundur dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave, informacionin që disponon në dosjet e saj, arkivën, sistemin e raportimit dhe bazën e të dhënave.

3.2 Në rast se AAC heton të njëjtën ngjarje si AKISA, AAC dhe AKISA do të sigurojnë respektimin e mandatit të njëri-tjetrit.

3.3 Nëse AAC dërgon një përfaqësues në vendin e një ngjarjeje, për të vlerësuar përgjegjësitë e AAC-së ose për të përcaktuar nëse kërkohet ndonjë masë e menjëhershme korrigjuese ose riparuese, përfaqësuesi do të përpiqet të kontaktojë me një nga investiguesit e AKISA-s në terren.

3.4 Në çdo aktivitet të ndërmarrë nga AAC, do të respektohen interesat e AKISA-s në lidhje me ruajtjen e provave. Megjithatë, kjo nuk do të jetë një pengesë që AAC të ndërmarrë çfarëdo veprimi që konsiderohet i nevojshëm në përmbushjen e detyrimeve të tyre në lidhje me veprimet e menjëhershme korrigjuese ose masat riparuese.

3.5 AAC dhe AKISA mund të bien dakord që një zyrtar i AAC-së të veprojë si vëzhgues ose hetues i jashtëm për qëllimet e një investigimi të sigurisë në operim nga AKISA, nën drejtimin e Investiguesit në detyrë. Në këtë rast, zyrtarit të AAC-së do t'i kërkohet të nënshkruajë një marrëveshje, duke njohur detyrimet dhe detyrat e tij/saj, në përputhje me nivelin e tyre të përfshirjes në një investigim të sigurisë në operim të transportit ajror.

tion, within its legislative authority, it will inform the AKISA.

2.4 Where AKISA is assessing the need to conduct an investigation into an occurrence, ACAA may decide to conduct its own investigation where it is empowered to do so. ACAA will inform AKISA of its decision to conduct an investigation, as soon as practicable.

### **3.0 COORDINATION OF INVESTIGATIVE ACTIVITIES**

3.1 With respect to occurrences that the AKISA is investigating, ACAA will make available on request, as soon as practicable, in compliance with the legislation in force for data protection, the information contained in their files, libraries, reporting systems and databases.

3.2 In the event ACAA is investigating the same occurrence as AKISA, ACAA and AKISA will ensure that each other's mandate is respected.

3.3 Should ACAA send a representative to the site of an occurrence, in order to evaluate ACAA's responsibilities or to determine if any immediate corrective or remedial measures are required, that representative will endeavor to make contact with any AKISA investigator on site.

3.4 In any activity undertaken by ACAA, the interests of AKISA with regard to evidence preservation will be respected. However, this will not be an impediment to ACAA taking whatever action is deemed necessary in fulfillment of their obligations relating to immediate corrective action or remedial measures.

3.5 ACAA and AKISA may agree that a ACAA official will act as an observer or an external investigator for the purposes of an AKISA safety investigation under the direction of the Investigator-in-Charge. In that case, the ACAA official will be required to sign an agreement, acknowledging his or her obligations and duties, appropriate to their level of involvement in an air transport safety investigation.

**3.6** Zyrtarët e deleguar nga AAC duhet të përgjigjen para Investiguesit në detyrë për gjithë kohëzgjatjen e një hetimi dhe të lirohen nga detyrat e tyre normale sipas nevojës gjatë dërgimit të tyre në hetim

**3.7** Zyrtari i AAC-së, i deleguar në AKISA, do të sigurojë që të mos ketë konflikt interesi gjatë kryerjes së detyrave të tij në mbështetje të AKISA-s. Megjithatë, AKISA do të lirojë nga detyra zyrtarin e dërguar, nëse konstatohet një konflikt interesi ose ndonjë konflikt tjetër.

**3.8** Zyrtarit të AAC-së do t'i jepet qasje në prova, në masën e nevojshme për t'i mundësuar Investiguesit në detyrë të përfundojë në mënyrë efektive hetimin.

**3.9** Duke pasur parasysh natyrën e mandatit të saj, AKISA normalisht nuk do të kërkojë që zyrtarët e saj të marrin pjesë në proceset rregullatore të AAC-së. Megjithatë, nëse AAC dhe AKISA bien dakord që pjesëmarrja e një zyrtari të AKISA-s në një proces rregullues të AAC-së është e përshtatshme, zyrtari i AKISA-s duhet të respektojë çdo udhëzim ligjor që i është dhënë nga zyrtari i AAC-së, përgjegjës për procesin rregullues.

**3.10** Nëse zyrtarët e AAC-së marrin pjesë në një vend aksidenti të kontrolluar nga AKISA, duhet të sigurohen se plotësojnë kërkesat minimale të AKISA-s për shëndetin dhe sigurinë në punë, si dhe kërkesat e pajisjeve mbrojtëse personale.

**3.11** Atëherë kur AKISA ka kërkuar që një zyrtar i AAC-së të marrë pjesë në një vend aksidenti për të ndihmuar në një investigim të AKISA-s, AKISA do t'i sigurojë zyrtarit të AAC-së çdo pajisje mbrojtëse të nevojshme për përdorim (p.sh. tuta, maska për fytyrën, doreza dhe syze sigurie).

#### **4.0 MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE**

**4.1** Rolet e AKISA-s dhe AAC-së do të respektohen në caktimin e përfaqësuesve në ICAO dhe takime të tjera ndërkombëtare, task-forca dhe grupe të tjera pune, që përfshijnë çështje të sigurisë në operim të transportit ajror. Përpara pjesëmarrjes, AKISA dhe AAC do të konsultohen dhe do të bien dakord për përfaqësimin e duhur, ndërkohë që pranojnë se,

**3.6** Officials seconded from the ACAA must be responsible to the Investigator-in-Charge for the duration of an investigation and relieved from their normal duties as necessary during their secondment to the investigation.

**3.7** The ACAA official seconded to AKISA shall ensure that there is no conflict of interest during the performance of his tasks in support to AKISA. However, AKISA shall release from his duties the official seconded, if conflict of interest or any other conflict is identified.

**3.8** The ACAA official will be given access to evidence to the extent necessary to enable the Investigator-in-Charge to effectively complete the investigation.

**3.9** Given the nature of its mandate, AKISA will not normally seek to have its officials participate in ACAA regulatory processes. However, if the ACAA and AKISA agree that participation by an AKISA official in an ACAA regulatory process is appropriate, the AKISA official must comply with any lawful direction given to them by the ACAA official in charge of the regulatory process.

**3.10** If ACAA officials attend an AKISA controlled accident site, they must ensure they meet the AKISA minimum occupational health and safety, and personal protective equipment requirements.

**3.11** Where AKISA has requested that an ACAA official attend an accident site to assist in an AKISA investigation, AKISA will provide the ACAA official with any required disposable protective equipment (i.e. overalls, face masks, gloves and safety glasses).

#### **4.0 INTERNATIONAL RELATIONS**

**4.1** The roles of AKISA and ACAA will be respected in assigning representatives to ICAO and other international meetings, task forces and other working groups involving air transport safety matters. Prior to attendance, AKISA and ACAA will consult and agree on appropriate representation, while recognizing that, for ICAO Accident Investigation Group divisional meetings



për mbledhjet e divizionit të Grupit të Hetimit të Aksidenteve të ICAO-s dhe për takimet e Panelit të Regjistruesit të Fluturimit, eksperti teknik zyrtar do të caktohet normalisht nga AKISA, në koordinim me AAC-në.

**4.2** AAC do të ofrojë shërbime koordinimi të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO) për departamentet dhe agjencitë e tjera. Pozicioni shqiptar që përfshin investigimin e ngjarjeve të aviacionit, do të jetë ai i AKISA-s, ndërsa pozicioni shqiptar në lidhje me regjistruesit në bord, do të marrë në konsideratë pikëpamjet ose propozimet e AKISA-s.

**4.3** Secila palë do të informojë tjetrën për një ngjarje jashtë Shqipërisë, sa më shpejt të jetë e mundur. Këtu përfshihen incidentet që përfshijnë avionë të regjistruar dhe/ose të prodhuar në Shqipëri, ose përbërës të tyre, të drejtuar nga një operator i huaj ose shqiptar; dhe

**4.4** Sipas Aneksit 13 të ICAO-s dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 739, datë 12.03.2021 "Për organizimin dhe funksionimin e autoritetit kombëtar të investigimit për sigurinë e operimit në aviacionin civil dhe rregullat për procesin e investigimit", përgjegjësia për caktimin e një Përfaqësuesi të Akredituar shqiptar në investigimin e një ngjarjeje aviacioni jashtë Shqipërisë, të kryer nga një shtet tjetër, i takon AKISA-s.

and for Flight Recorder Panel meetings, the official technical expert will normally come from the AKISA, in coordination with ACAA.


**4.2** ACAA will provide International Civil Aviation Organization (ICAO) coordination services to other departments and agencies. The Albanian position involving aviation occurrence investigations will be that of the AKISA, while the Albanian position regarding on-board recorders will take into consideration the views or proposals of the AKISA.

**4.3** Each party will inform the other of an occurrence outside of Albania, as soon as practicable. These include occurrences involving Albanian registered and/or manufactured aircraft, or component thereof, operated by a foreign or Albanian operator; and

**4.4** Under ICAO Annex 13 and the Decision of Council of Ministers No.739, dated 03.12.2021 "On the organization and functioning of the national investigation authority for the safety of operation in civil aviation and the rules for the investigation process", the responsibility for appointing an Albanian Accredited Representative to an investigation of an aviation occurrence outside Albania, conducted by another state, lies with AKISA.

**AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL  
SHQIPTAR/**

**ALBANIAN CIVIL AVIATION  
AUTHORITY**

  
**MAKSIM ET'HEMAJ  
DREJTOR EKZEKUTIV/  
EXECUTIVE DIRECTOR**

**Data e nënshkrimit/**

**Date signed:** 20.02.2024

**AUTORITETI KOMBËTAR I  
INVESTIGIMIT TË SIGURISË NË OPERIM  
NË AVIACIONIN CIVIL/**

**NATIONAL AUTHORITY FOR SAFETY  
INVESTIGATION IN CIVIL AVIATION/**

**GENCI RESULTI  
DREJTOR EKZEKUTIV/  
EXECUTIVE DIRECTOR**

**Data e nënshkrimit/**

**Date signed:** 20.02.2024



*Gene Result*

